

LIGJ
Nr.7575, datë 29.6.1992

PËR NJË NDRYSHIM NË KODIN CIVIL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 283 ndryshohet si vijon:

"Kur në banesën shtetërore të zënë nga qiramarrësi krijohet një tepricë sipërfaqeje banimi tej normës së caktuar dhe kjo tepricë përbën dhomë të veçantë e më tepër, organi ekzekutiv i pushtetit në rreth ka të drejtë të vendosë për strehimin e shtetasve të tjerë në sipërfaqen tepricë të banimit, ose lirim të banesës nga qiramarrësi duke i dhënë atij një banesë tjetër brenda normave për plotësimin e nevojave të familjes së tij. Për këtë qëllim mund të bëhen edhe adoptime në këto banesa.

Kur qiramarrësi kundërshton vendimin e marrë, nxirret urdhër administrativ. Kundër këtij urdhri mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve të kryetari i organit ekzekutiv të pushtetit në rreth, akti i të cilit është i formës së prerë.

Sipërfaqet në banesat shtetërore të lëshuara me nënqira nga qiramarrësit trajtohen si sipërfaqe tepricë banimi. Qiratë e vjelura nga këto banesa kalojnë në buxhetin e shtetit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë

Shpallur me dekretin nr.250, datë 14.7.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.